



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / KOSOVA CUMHURIYETI**

---

**C.nr.199/14**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Valon Totaj, me procesmbajtësen Drita Qerreti në kontestin e paditëses N. B., e lindur K. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. B. N. nga Prizreni, kundër të paditurit E. B. nga Prizreni, për shkak të shpërnguljes, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 29.08.2014, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET kërkesëpadia** e paditëses N. B., e lindur K. nga Prizreni, si e bazuar.

**II. DETYROHET i padituri** E. B. nga Prizreni, që të liroj shtëpinë familjare me të gjithë personat dhe gjësendet, e cila shtëpi është ndërtuar në ngastrën kadastrale 71813068 - ..., në sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup>, ZK Prizren, si dhe që paditëses t'ia paguaj shpenzimet procedurale në lartësi prej 513 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

*Pretendimet e palëve*

Paditësja N. B., e lindur K. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj av. B. N. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit E. B. për shërngulje, në të cilën padi ka theksuar se ajo është pronare e shtëpisë familjare e cila është ndërtuar në ngastrën kadastrale 71813068- ..., në sipërfaqë prej 400 m<sup>2</sup>, ZK Prizren. Paditësja këtë ngastër kadastrale në të cilën është ndërtuar shtëpia familjare, e ka blerë me anë të kontratës mbi

shitblerjen e patundshërisë Leg.nr...., të datës ..., të lidhur midis saj, si blerëse në një të anë dhe F. Th., si shitës në anën tjetër. Padiësja ka theksuar se në shtëpi përveç saj banon edhe bashkëshorti i saj, vjehra e saj A. B. dhe i padituri me bashkëshorten. Më tutje ka cekur se i padituri kohëve të fundit bënë probleme familjare dhe me këtë shqetëson si padiësen, bashkëshortin e saj ashtu edhe vjehrën e saj, ku kohëve të fundit përveç mosmarrëvejeve serioze, i padituri ka filluar të jetë edhe agresiv e sidomos ndaj vjehrës së padiësës A. B. për të cilën kanë parashtruar edhe kërkesë për urdhër mbrojtje sa i përket saj. Me këkë ka kërkuar që të aprovohet padia e saj dhe të obligohet i padituri, që menjëherë të liroj shtëpinë familjare e cila është objekt i këtij kontesti.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i padiësës av. B. N. nga Prizreni, ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që në bazë provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të bjenë aktgjykim me të cilin do të aprovon kërkesëpadinë e padiësës si e bazuar. Po ashtu ka propozuar që gjykata të obligon të paditurin të paguan shpenzimet procedurale dhe atë: për përpilimin e padisë 105 euro dhe për qdo përfaqësim në tri seanca e mbajtura nga 136 euro.

Me anë të përgjigjes me shkrim në padi, i padituri E. B. ka theksuar se padia e padiësës është e pa bazuar dhe të njëjtën gjykata duhet ta refuzoj, duke shtuar se, shtëpia familjare në sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup> është e ndërtuar para 3 vite, me para të cilat babai i tij G. B. i ka siguruar duke e shitur një shtëpi tjetër të vjetër e cila ka qenë në emrin e tij – babait. Po ashtu ka deklaruar se në shtëpinë e re tani banojnë 3 vllazër si trashigimtar të barabartë, pra E. këtu i padituri, E. dhe R.. Më tutje ka deklaruar se vllau E. ka pas për t'ia paguar atij pjesën trashëgimore, ose t'ia blej një banes kur të martohet, ndërsa për këtë kanë garantuar nëna A. B. dhe E. B., por deri më tani këto premtimet nuk i kanë përmbushur. Ai po ashtu ka cekur se vllau E. pronësinë e shtëpisë e ka bartë te bashkëshortja e tij pa dijeninë familjare, ndërsa si pronar të vërtet pretendon se janë tre vllazër E., R. dhe E. këtu i padituri.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: Kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg.nr. ...., të datës ..... dhe çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-71813068-.... të datës ....., për ngastrën kadastrale me nr. ... ZK Prizren.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është **e bazuar**.

Në bazë të kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë leg.nr...., të datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësja N. B. e lindur K., me ish shitësin F. Th., kanë lidhur kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë në vendin e quajtur “K.”, respektivisht ngastrës kadastrale nr...., sipas listës poseduese (të vjetër) me nr.... ZK Prizren, në sipërfaqe prej 400 m2.

Në bazë të çertifikatës mbi te drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-71813068... të datës ..., gjykata ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale nr. ..., ZK Prizren, në sipërfaqe prej 400 m2, evidentohet në emër të këtu paditëses N. B., e lindur K.

#### *Baza ligjore*

Sipas nenit 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera Sendore (LPDTS) **“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veqanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtoj nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”**.

#### *Vlerësimi përfunditarë i gjykatës*

Nga të gjitha faktet e administruara, pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazës ligjore të cekur më lartë, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet aprovohet si e bazuar. Kjo për faktin se me kontratën mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg.nr...., të datës 31.12.2010, të lidhur midis këtu paditëses N. B. si blerëse dhe pronarit të më hershëm të saj F. Th. si shitës, vërtetohet se paditësja e kishte blerë ngastrën kadastrale nr. .. ZK Prizren dhe atë në sipërfaqe prej 400m2, në të cilën edhe gjendet godina familjare. Kësaj prove gjykata i’a fali besimin e plotë. Po ashtu, bazuar në çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL-71813068-..., të datës ....., vërtetohet se tani ngastra kadastrale nr.... ZK, në të cilën gjendet godina familjare evidentohet në emër të këtu paditëses N. B., e lindur K. dhe atë si pronare e vetme e saj. Kësaj prove gjykata po ashtu i’a fali besimin e plotë. Duke qenë se në bazë të së drejtës pozitive, paditësja N. B., e lindur K. është pronare e shtëpisë familjare e cila është e ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 71813068... në sipërfaqe prej 400 m2, ZK Prizren, dhe se i padituri në këtë shtëpi është duke jetuar së bashku ma bashkëshorten e tij, gjykata vlerëson se në këtë rast, ajo si pronare ka të drejtë që të kërkojë nga i padituri, që menjëherë të liron shtëpinë familjare me të gjitha personat dhe gjësendet. Andaj, gjykata ka ardhë në përfundim se padia e paditëses duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par.1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: për tri seanca gjyqësore nga 136 euro secila prej tyre, si dhe për përpilimin e padisë 105 euro, respektivisht shuma e tërësishme e shpenzimeve të procedurës në lartësi prej 513 euro.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.199/14, me datë 29.08.2014**

Procesmbajtësja,  
Drita Qerreti

**Gjyqtari,**  
**Valon Totaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.